

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRILSDHIVA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 429 Nr. i faq./Br.str./No.pg 136  
Data/Datum/Date 7 / 4 / 23  
RAHOVEC / ORAHOVAC



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e Auditimit të Brendshëm  
Komuna e Rahovecit

## RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Për periudhën 01.01.2023 - 31.03.2023

07.04.2023

## **Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar - Mars të vitit 2023**

Në periudhën Janar – Mars, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2023, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Mars të vitit 2023, kemi arritur të kryejmë 1 (një) auditim, sipas planit vjetor të punës.

Në listën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për periudhën Janar - Mars të vitit 2023 sipas Planit Vjetor.

### **Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Mars të vitit 2023**

1. Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike Komunale, auditim i përfunduar.
2. Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, auditim në proces.

### **Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2023 – 2025, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2023.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2022, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2022.
- Si aktivitete tjera mund të cekem ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuarashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollat gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

